



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:163109
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05750795

Ac.nr.1196/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Besnik Bislimaj- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve S. C., M. C., H.G., L. C., V.C., E.C. dhe E. C. – të gjithë nga Fshati K. e p, Komuna e G., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokat H. J.me seli të zyrës në P., Rr. xxxx, kundër të paditurës K. E e K. (KEK) Sh.A. me seli në P., xxxx, për shkak të padisë për kompensimin e dëmit material dhe jo material për shkak të lëndimit në punë të paditësit të parë pranë të paditurës, duke vendosur sipas anekesave të palëve ndërgjygjëse të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.51/12, të datës 05.11.2020 në seancën e kolegjit të mbajtur më **20.05.2024** nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHEN SI TE BAZUARA, ankesat e paditësve S. C. etj të gjithë nga fshati K. e P./Komuna e G.ushtuar përmes të autorizuarit të tyre avokat H. J. nga P., si dhe ankesa e të paditurës K. E. E.e K.-KEK sh.a me seli në Prishtinë, **ANULOHE**T Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.51/12, i datës 05.11.2020 dhe çështja i kthehet në **ri gjykim**, gjykatës së shkallës së parë .

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me aktgjykimin e ankimuar C.nr.51/12 të datës 05.11.2020 ka vendosur si në vijim:

1. **MIRATOHET PJESËRISHT** e bazuar kërkesëpadia e paditësit S. C.nga Fshati K.ë e P.-Komuna e G. dhe **DETYROHET** e paditura K. E. e K. Sh.A. me seli në P., që në emër të lëndimit të pësuar në vendin e punës më datën 10.10.2011, t'ia kompensojë paditësit shumat si në vijim:
 - 1.1. Në emër të dëmit jo material

- 1.1.1. Për dhimbje fizike të përjetuar shumë:3000 euro
- 1.1.2. Për frikën e përjetuar, shumë:2500 euro
- 1.1.3. Për zvogëlimin e aktivitetit jetësor në shkallë 19%: 11000 euro)
- 1.1.4. Për amputimin e gishtërinjve III, IV, V, kontrakturave të gishtit I dhe II dhe njollat cikatriciale në regjionin e shuplakës së majtë të dorës shumë:17000 euro
- 1.2. Në emër të dëmit material:
 - 1.2.1. Për ndihmën e dhënë nga personi i tretë shumë:400 euro
 - 1.2.2. Për ushqimin e përforcuar, shumë :400 euro
 - 1.2.3. Për rehabilitimin fizio-terapeutik, sipas faturës e datës 03.04.12, shumë: 560 euro,
me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuara pa destinim të caktuar në ndonjërin nga bankat e Kosovës, e cila llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi 05.11.2020 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përbarimit me dhunë.
2. APROVOVHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve M. C., H. G., L. C., V.C., E. C.dhe E. C. – të gjithë nga Fshati K. e p., Komuna e G., dhe DETYROHET e paditura K. E. e K. Sh.A. me seli në P., që në emër të dëmit jo material t'i kompensojë paditësve në shumat si në vijim:
 - 2.1. M. C.në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, shumë:1300 euro
 - 2.2. H. G., në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, shumë:1300 euro
 - 2.3. L.C.në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, shumë:1300 euro
 - 2.4. V. C., në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, shumë:1300 euro
 - 2.5. E. C., në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara,shumë:1300 euro
 - 2.6 E. C., në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, shumë :1300 euro

secilit me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuara pa destinim të caktuar në ndonjërin nga bankat e Kosovës, e cila llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi 05.11.2020 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se këtij aktgjykim e nën kërcënim të përbarimit me dhunë .

REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e dëmit, përtej shumave të gjykuara si në pikën 1 dhe 2 të dispozitiviti të këtij Aktgjykimi.

DETYROHET e paditura KEK sh.a., paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë: 3013.20 euro në afatin kohor prej 15 ditësh nga data e pranimit të aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë kanë paraqitur paditësit, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shpenzimeve të procedurës me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar vetëm sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës ashtu që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi sipas precizimit të datës 22.10.2020.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën

si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar në tërësi kërkuespadinë e paditësve apo që çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësve është e bazuar.

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, H.J., avokat nga P. me datë 05.01.2012 kanë ushtruar padi për kompensim dëmi kundër të paditurës K. E. e K.(KEK) Sh.A. me seli në P.. Përfaqësuesi i paditësit të parë ka deklaruar se në kohën e shkaktimit të aksidentit, në datën 10.10.2011, paditësi i parë ka qenë në vendin e tij të punës pranë të paditurës si Axhystator në Eskavator – ku edhe më tutje vazhdon të punojë. Lëndim ka pasuar gjatë vendosjes së siguresës së kushinetës rrëshqitëse në reduktorin e rrotës punuese të eskavatorit, i cili është mbajtur me vinç, dhe për një moment është spostuar dhëmbëzori i lidhur me litar për vinç duke i rënë në dorë të majtë paditësit, me çka e ka akisdentuar të njëjtin duke i këputur gishtat e dorës së majtë. Pas nxjerrjes së provës me ekspertizë nga lëmia e sigurisë dhe e mbrojtjes në punë – për të konstatuar përgjegjësinë primare për lëndimin në punë, provës me super ekspertizë nga lëmia ortopediko-traumatologjike dhe psikiatrike – për tu konstatuar shkalla e invaliditetit të paditësit dhe dhimbjeve e frikës, si dhe pas nxjerrjes së provës me dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar, sipas parashtresës për precizimin e kërkesëpadisë për nga lartësia – datë 22.10.2020, paditësi S. C.përmes të autorizuarit të tij i propozoi gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura ta kompensojë paditësin për dhimbjet e përjetuara 10.500 euro, në emër të frikës së përjetuar 10.000 euro, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 30.850 euro, në emër të amputimit të gishtërinjve III, IV, V, kontrakturave të gishtit I dhe II dhe njollat cikatriciale në regjionin e shuplakës së majtë të dorës shumë 45.580 euro, për ndihmën e dhënë nga personi i tretë 600 euro, për ushqimin e përforcuar 800 euro dhe për rehabilitimin fizio-terapeutik 560 euro - të gjitha këto me kamatë ligjore 8%, nga data e dorëzimit të padisë e deri në pagesën definitive. Me parashtresën e datës 23.01.2017 dhe nga deklaratimet e dhëna në shqyrtim përgatitor, paditësi e ka zgjeruar padinë në kuptimin subjektiv, ku si paditës paraqiten edhe familjarët e S. C., bashkëshortja M. C., dhe fëmijët H. G. (e gjinisë C.), L. C., V.C., E. C. dhe E. C. duke i propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e tyre si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësit t'i kompensojë si në vijim: M. C., 8.000 euro, H. G.dhe V. e L. C.nga 7.000 euro ndërsa E. dhe E. C.nga 6.000 euro. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar, dhe atë: 325 euro për përpilimin e padisë, 325 euro për përpilimin e precizimit të kërkesë padisë, 5.200 euro për përfaqësim në 8 seanca gjyqësore, 153.30 euro për përpilimin e ekspertizës së sigurisë në punë, 750 euro për përpilimin e ekspertizave mjekësore nga lëmia ortopedike-traumatologjike dhe psikiatrike (5x150.00 euro), si dhe 100 euro për pagesën e taksës gjyqësore të padisë.

E paditura KEK Sh.A. me seli në Prishtinë me përgjigjen në padi të datës 28.07.2015 si dhe në deklaratimet e dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve – si për nga baza, ashtu edhe për nga lartësia, duke theksuar se paditësi S. C. ka qenë i trajnuar nga lëmia e sigurisë në punë, dhe është dashur të dijë vetë si të veprojë e reagojë në kryerjen e punëve. Këtë fakt e paditura e mbështet edhe në përvojën shumë vjeçare të paditësit të parë, si axhystator pranë të paditurës. Andaj e paditura konsideron se paditësi ka pësuar aksident në vendin e punës për shkak të lëshimeve të tija dhe jo për shkak të fajit të paditurës, sepse vendi i punës ka qenë i mobilizuar si çdoherë tjetër dhe në gjendje të rregullt, dhe se vendi i punës së paditësit nuk paraqet rrezikshmëri të shtuar për punë. Tutje e paditura ka shtuar se paditësi nuk ka parashtruar fillimisht kërkesë për kompensim tek e paditura po ka vepruar direkt me padi. Lidhur me shpenzimet e mjekimit / operimit me rastin e lëndimit, e paditura ka deklaruar se e njëjta i ka paguar këto në tërësi. Në bazë të raportit nr. 49 datë 25.10.2011 konstatohet se aksidenti ka ndodhur nga veprimi i pasigurt i punëtorit në vendin e punës. Lidhur me zgjerimin e padisë së paditësit në kuptim subjektiv, ku si paditës ishin bashkuar edhe familjarët e ngushtë të paditësit të parë, e paditura e kundërshtoi në tërësi, dhe atë me parashtrësën e datës 23.05.2018 si dhe parashtrësën e datës 22.01.2020, e po ashtu edhe në deklaratimet e dhëna në shqyrtim gjyqësor, sepse konsideron që kërkesa e palëve është parashtruar. Kjo për faktin se paditësi ka pësuar aksident në vitin 2011 ndërkaq kërkesën për kompensim të familjarëve në cilësi të paditësve për shkak të lëndimit të paditësit të parë, me pasojë zvogëlimin e aktivitetit jetësor, e kanë parashtruar në vitin 23.01.2017, pas afatit të paraparë në nenin 376 apo 357 të Ligjit për marrëdhëniet e Detyrimeve, ku është përcaktuar se kërkesat për shpërblimin e dëmit paraqiten brenda afatit 3 vjeçar nga momenti kur kanë mësuar për shkaktimin e dëmit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar, por propozoi që në rast të aprovimit të kërkesëpadisë, të merret parasysh praktika gjyqësore dhe rregullorja e BQK-së për kompensime, si dhe shpenzimet të aprovohen sipas tarifës së suksesit në këtë çështje.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka caktuar seancë gjyqësore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.51/12 të datës 05.11.2020 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ka theksuar në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar në K. E. të K. – KEK / e paditura, sipas kontratës përkatëse të punës në pozitën Axhystator (Prova nr. 1 dhe 15). Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se e paditura e ka dërguar për në shërbim spitalor emergjent dhe operim në mënyrë të menjëhershme paditësin dhe se i ka mbuluar të gjitha shpenzimet e mjekimit/operimit. Si çështje kontestuese është caktimi i përgjegjësisë së palëve ndërgjyqëse në rastin e shkaktimin të aksidentit nga i cili është lënduar paditësi S. C. në datën 10.10.2011. Si çështje kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse mbeti baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë në përgjithësi, për dëmin material dhe jo material nga lëndimi në punë i paditësit S. C., dhe familjarëve të tij. Në seancën e datës 13.06.2018, gjykata ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve palët e propozuara nga paditësi, të cilët kanë qenë prezent në vendngjarje kur është shkakuar lëndimi në punë, dhe atë: Baki Zeqiri, Muhamet Rupica dhe Musa Mjekiqi. Baki Zeqiri ka deklaruar se ngjarjen e ka parë duke qenë në distancë prej 1 metri nga vendi i lëndimit,

ndërkaq Muhamet Rupica ka shtuar (nën deklaratimet e njëjta) se e ka ndihmuar Bakiun që ta lëvizin dhëmbëzorin për t'ia nxjerr dorën e aksidentuar paditësit nga pajisja. Tutje, dëshmitari Musa Mjeku ka shtuar se gjithçka ka ndodhur krejt papritmas kur në të njëjtin vend të punës, paditësi ka qenë duke e vendosur siguresën kur i ka ndodhur lëndimi. Për vlerësimin e fakteve kontestuese lidhur me përgjegjësinë për lëndimin e paditësit, gjykata nxori si provë ekspertizën e nga lëmia e sigurisë në punë, të përpiluar nga eksperti Azem Kyçyku e datës 08.10.2018, të cilën gjykata e ka caktuar në bazë të aktvendimit të datës 24.09.2018. Sipas kësaj ekspertize, është konstatuar se shkaktar i lëndimit të paditësit në punë është mos sigurimi i masave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë nga punëdhënësi / e paditura dhe mospërfillja e këtyre masave në mënyrë të duhur nga punëmarrësi / paditësi. Respektivisht, sipas ekspertizës, e paditura KEK nuk ka siguruar masat e duhura të sigurisë në punë sepse:

- Sipas ligjit 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, kushtet për punë të sigurt në vendin e punës, duke përfshirë edhe ndërmarrjen e masave preventive për eliminimin e rreziqeve të mundshme i krijon punëdhënësi (neni 2).
- Punëdhënësi, respektivisht Përgjegjësit e shërbimeve përkatëse, nuk kanë organizuar si duhet kryerjen e punëve konform rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë.
- Punëdhënësi, nuk ka instaluar tek të punësuarit e tij disiplinën dhe përgjegjësinë e duhur në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes në punë – gjë që shihet nga mungesa e aplikimit të Urdhërësës së punës me shkrim për kryerjen e punëve delikate, siç ka qenë ajo e ndërrimit të unazave të kushinetës rrëshqitëse të rrotës punuese.
- Përgjegjësit e shërbimeve të involvuara në këtë rast nuk kanë ndërmarrë masat e sigurisë që hapësira në të cilën duhet punëtorët t'i fusin duart për kryerjen e veprimeve punuese të jetë e sigurt nga rënia eventuale e ngarkesë së varur në çengelin autovinçit.
- Konstatimi i Komisionit profesional në Raportin nr. 2343 të datës 21.10.2011 se shkaktar i aksidentit është "*rrëshqitja e litarit në marseta (shtrënguese)*" tregon për pakujdesi dhe papërgjegjësi profesionale të përgjegjësit të ekipës që ka udhëhequr intervenimin atë ditë në Eskavator, respektivisht në reduktorin e rrotës punuese.

Respektivisht, nga punëtori/paditësi S. C., nuk janë respektuar plotësisht masat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë sepse punëtori nuk është dashur të fut duart në hapësirën e pasiguruar paraprakisht nga rënia e ngarkesës, dhe se paditësi ka pasur të drejtë ta refuzojë urdhëron e Udhëheqësit të vet për të vepruar nën ngarkesën e varur në një situatë të tillë.

Si përfundim në bazë të kësaj ekspertize dhe mendimit profesional të ekspertit, përgjegjësia primare në rastin e lëndimit ka qenë e punëdhënësit KEK, ndërsa përgjegjësia sekondare mund t'i lihet vetë punëtorit S. C..Lidhur me konstatimet e tij, eksperti i çështjes ka prezantuar në seancën e datës 04.01.2019, i cili në pyetjet dhe përgjigjet nga përfaqësuesit e palëve ka deklaruar se ka vizituar vendin e ngjarjes, dhe pasi mori për bazë të gjitha provat e shkresat e çështjes, konstatoi ndarjen e përgjegjësisë në mes të punëdhënësit dhe punëtorit si më lartë.Gjykata vlerësoi se ekspertiza e elaboruar si më lartë është nxjerr në harmoni me kërkesat ligjore nga Ligji 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës – Neni 2 – i cili ka qenë i zbatuar në kohën e lëndimit në punë, dhe gjykata ia fali besimin kësaj ekspertize meqë e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale dhe e mbështetur në prova e fakte relevante (si: marrja në pyetje e paditësit S. C., shkresat e tërësishme të lëndës – përfshirë dokumentacionin mjekësor, foto dokumentimi i vendit të ngjarjes, deklaratat e punëtorëve

prezent, vizita në vendin e ngjarjes. Për të vlerësuar llojin dhe lartësinë e dëmit të shkaktuar ndaj paditësit S. C., Gjykata mori për bazë nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë me traumatologji me tre ekspertë (Doktorët: Vjollca Binçe, Halit Gërbeshi dhe Qerim Kida) dhe ajo e psikiatrisë (Doktor Valbona Blakaj). Sipas ekspertizës së përbashkët të lartëcekur të datës 29.11.2019, paditësi ka përjetuar lëndime trupore të cilat hyjnë në kategorinë e lëndimeve të rënda trupore, i cili me rastin e lëndimit në punë ka përjetuar “Crush Trauma” apo traume me frakturë të shumëfishtë në dorën e majtë, si pasojë e së cilës i janë amputuar gishtit 3 dhe 4 i dorës së majtë, ka pasur amputim në nivelin e artikulacionit interfalangeal proksimal të gishtit të pestë, ka pësuar kontrakturë të nyjës metakarpofalangeale dhe interfalangeale në gishtin e dytë çekiç të dorës së majtë. Për shkak të lëndimit të përjetuar si më lartë, gjykata konstaton se në bazë të ekspertizës mjekësore, paditësi S. C. ka përjetuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje 60 minutshe e përjetuar në vendin e ngjarjes së lëndimit në punë; dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje 4 ditë deri në veprimin e terapisë pasi që paditësi ka pësuar lëndime të shumëfishta; dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje 40 ditore – kohë kjo gjatë se cilës tërhiqen hematoma dhe inflamacionet post-traumatike nën veprimin e terapisë, dhe e nevojshme për rehabilitimin e indeve të lënduara nga shtypja e marrë; dhimbje fizike të intensitetit të ultë të cilat janë prezentë edhe sot – sipas bashkëbisedimit me pacientin / paditësin, i cili përjeton sforcime fizike sidomos gjatë lëvizjes së gushtit të dytë i cili është në pozitë çekiç. Për shkak të lëndimit në punë dhe dhimbjet e përjetuara, në bazë të ekspertizës mjekësore, gjykata konstaton se paditësi S. C. ka përjetuar frikë të intensitetit dhe llojit të ndryshëm, dhe atë si në vijim: frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, nga momenti i goditjes direkte i dorës së majtë me peshë të rëndë e deri te largimi përfundimtar i asaj peshe, e cila ka ngjallur ndjenjë të përfundimit fatal / vdekjes, frikë sekondare e intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 7 ditë, e shoqëruar me simptoma të gjendjes pas traumës, e shfaqur me shqetësim, ankth, parehati, dhe frikë nga invaliditeti për shkak të lëndimeve serioze të pësuar në aksident. Gjatë kësaj periudhe është bërë përpunimi i plagës dhe amputimi i gishtërinjve, frikë sekondare e intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur 6 muaj, dhe paditësi ka pasur preokupim dhe angazhim për gjendjen shëndetësore të papritur dhe pa planifikuar të cilës me vështirësi i është adaptuar pas amputimit të gishtërinjve dhe herë pas here kjo gjendje i është përcjellë me rënie të vullnetit dhe disponimit si dhe me ndjenja të mosvlerësimit dhe humbjes së shpresës, frikë sekondare të intensitetit të ultë e cila zgjat edhe sot, për shkak të invaliditetit të krijuar dhe pamundësisë për të funksionuar në mënyrë të pavarur, bazuar edhe në moshën e tij, e që në vazhdimësi ballafaqohet me ndjenjën e stigmes (turpit) si ën rrethin familjar ashtu edhe social për shkak të shëmtimit / invaliditetit të dukshëm. Tutje me anë të ekspertizës së lartëpërmendur konstatohet se paditësi ka shkallë të lartë të shëmtimit trupor për shkak të pozitës jo të mirë të gishtit të dytë dhe humbjes së gishtit të tretë dhe katërt si dhe gjysmës së gishtit të pestë të dorës së majtë. Paditësi S. C. për shkak të lëndimit në punë ka zvogëlim të aktivitetit jetësor 19%, llogaritur sipas formulës së Balthazar-it, Kap. III, pika 1.5.4 – b) dhe c) si dhe pika 1.8. a). – tabelë e aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Banka Qendrore e Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata ia fali besimin ekspertizës mjekësore të elaboruar si më lartë, pasi që ekspertët nga lëmit përkatës në mënyrë profesionale dhe objektive janë deklaruar për të gjitha kategoritë e dëmit të pësuar nga paditësi, në pajtim me detyrat e përcaktuara nga gjykata, si në kuptimin material ashtu edhe atë jo-material. Lidhur me kërkesëpadinë e paditësve të tjerë – familjarëve M. C., H. G., . C., V. C., E. C. dhe E. C.– të gjithë nga Fshati K. e p., Komuna e G., meqë u konstatua

përgjegjësia primare e shkaktimit të lëndimit në punë të paditësit të parë S. C., në bazë të ekspertizës mjekësore psikiatrike, gjykata ka konstatuar se familjarët si më lartë fillimisht me marrjen e lajmit për aksidentin/ incidentin, kanë përjetuar frikë se a po i mbijeton bashkëshorti / babai aksidentit apo jo, e pastaj gjendja e rënde shëndetësore, e krijuar në mënyrë të shpejtë e të papritur ka krijuar konfuzitet, shpërthime emocionale, ankth, mërzi dhe paretat për palët paditëse. Këto dhembje shpirtërore, gjykata i konstatoi se kanë ekzistuar si në vijim për secilin anëtar të familjes veç e veç: Paditësja M. C. ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë 8 muaj - me ndjenjë të zbrazësisë, përlotje, ankth të gjeneralizuar dhe vështirësi për të pranuar pasojat e aksidentit të bashkëshortit të saj, të intensitetit të mesëm 10 muaj, dhe të intensitetit të ultë – dhimbje këto që vazhdojnë ende edhe sot, pasi bashkëshorti i saj ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme dhe nuk është në gjendje që të realizoj rrolin e tij të plotë si bashkëshort dhe si prind. Paditësja H. G. (bija e S. C.), ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë 5 muaj - me ndjenjë të zbrazësisë, përlotje, ankth të gjeneralizuar dhe vështirësi për të pranuar pasojat e babait të saj, të intensitetit të mesëm 6 muaj, dhe të intensitetit të ultë – dhimbje këto që vazhdojnë ende edhe sot, pasi që babai i saj ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme. Paditësja V. C. (bija e S. C.), ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë 5 muaj - me ndjenjë të zbrazësisë, përlotje, ankth të gjeneralizuar dhe vështirësi për të pranuar pasojat e babait të saj, të intensitetit të mesëm 6 muaj, dhe të intensitetit të ultë – dhimbje këto që vazhdojnë ende edhe sot, pasi që babai i saj ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme. Paditësja L. C. (bija e S. C.), ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë 5 muaj - me ndjenjë të zbrazësisë, përlotje, ankth të gjeneralizuar dhe vështirësi për të pranuar pasojat e babait të saj, të intensitetit të mesëm 6 muaj, dhe të intensitetit të ultë – dhimbje këto që vazhdojnë ende edhe sot, pasi që babai i saj ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme. Paditësja E. C. (bija e S. C.), ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë 2 muaj - me përlotje dhe mërzi duke tentuar që ta kuptojë situatën e re të krijuar në familje; dhimbje të intensitetit të mesëm 2 muaj me paretat e frustrim e me ndjenjë të hidhërimit e frikës se a do t'i shërohet babai, si dhe dhimbje të intensitetit të ultë – dhimbje këto që vazhdojnë ende edhe sot, pasi që babai i saj nuk është në gjendje t'ia plotësojë nevojat e kërkesat e përditshme. Paditësi Egzonë C. (i biri S. C.), ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë 2 muaj - me përlotje dhe mërzi duke tentuar që ta kuptojë situatën e re të krijuar në familje; dhimbje të intensitetit të mesëm 2 muaj me paretat e frustrim e me ndjenjë të hidhërimit e frikës se a do t'i shërohet babai, si dhe dhimbje të intensitetit të ulur – dhimbje këto që vazhdojnë ende edhe sot, pasi që babai i tij nuk është në gjendje t'ia plotësojë nevojat e kërkesat e përditshme. Andaj, gjykata e shkallës së parë e aprovoj pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke e bazuar vendimin e saj në nenin 154, 155 dhe nenin 201 paragrafin 3 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (ligji i vitit 1978 i aplikueshëm në kohën kur ka ndodh aksidenti). Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 277 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (viti 1978) , ndërsa në raport me shpenzimet e procedurës vendimin e saj e bazoi në nenin 449, 452 par. 2 dhe 453 të LPK-së. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlihet me dëmin material dhe jo material për të gjitha palët paditëse si në pikën 3 të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi në këtë mënyrë pasi kompensimi i referohet përgjegjësisë respektivisht kontributit për shkaktimin e lëndimit në punë nga mos-vëmendja e duhur në kryerjen e detyrave të punës, dhe sipas vlerësimit të gjykatës, kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të shërbente qëllimit të shpërblimit të dëmit, sepse

tejkalon standardin jetësor-ekonomik në Kosovë, dhe kalon përtej arsyeshmërisë së kompensimit.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit tani për tani nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme për arsye se, aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore nga neni 182.2, pika (n) i LPK-së, meqë aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten, nuk është në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin e aktgjykimit, ndërsa faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar mjaftueshëm, për çka edhe është bërë vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike. Gjithashtu, në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë, duke mos e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësve, ka zbatuar në mënyrë të gabuar edhe të drejtën materiale.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në kufijtë e pretendimeve ankimore, Gjykatës së Apelit i ka rezultuar se me rastin e vendosjes, gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë bazën juridike dhe lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit material dhe jo material, në raport me të paditurën K. E. e K. (KEK) Sh.A., nga e cila bazë do të rrjedh obligimi i të paditurës për kompensimin e tillë të paditësve. Kjo për faktin se, referuar shkresave të lëndës rezulton se është fakt jo kontestues se si pasojë e aksidentit në punë të shkaktuar më 10.10.2011, paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore (të konstatuara me ekspertizën mjekësore të ekspertëve Dr. Vjollca Binçe ortopedë-traumatologe, Halit Gërbeshi –ortoped traumatolog dhe Qerim Kida dhe Dr. Valbona Blakaj psikiatër), ndërsa sipas ekspertizës lidhur me shkaqet e lëndimit në punë të përpiluar nga eksperti Azem Kycyku me datë 08.10.2018, është konstatuar se shkakuar i lëndimit të paditësit në punë është mos sigurimi i masave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë nga punëdhënësi/e paditura dhe mospërfillja e këtyre masave në mënyrë të duhur nga punëmarrësi /paditësi ku sipas ekspertit përgjegjësia primare i takon të paditurës, ndërsa paditësi ka përgjegjësi sekondare në aksidentin e ndodhur.

Si rrjedhojë, në mënyrën se si ka vendosur gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar, kur ka detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të dëmit jo material për dhimbje fizike, për frikën e pësuar, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për amputimin e gishtërinjve si dhe në emër të dëmit material për ndihmën e personit të tretë, për ushqimin e përforcuar, për rehabilitimin fizio-terapeutik si pasojë e aksidentit në punë të ndodhur më 10.10.2011, është plotësisht e paqartë, kontradiktore dhe jo e bazuar në ligj. Në fakt, me rastin e caktimit të ekspertit nga lëmia e e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, Dr.Sc. Azem Kycyky i cili ka pasur për detyrë që pas analizë së provave dhe shkresave të lëndës , ta jep mendimin profesional lidhur me shkaqet e aksidentit dhe përgjegjësinë eventuale të palëve në aksidentin në punë të ndodhur me datë 10.10.20211 në të cilin është lënduar i padituri, i njëjti ka përpiluar ekspertizën me datë 08.10.2018 duke shpjeguar rrjedhën e ngjarjes duke përshkuar rastin dhe lëshimet e palës paditëse dhe asaj të paditur, ku sipas tij përgjegjësi primare në aksident ka i padituri ndërsa përgjegjësi sekondare ka paditësi. Sipas nenit 362 , paragrafi 1 të LPK-së , eksperti është ftuar në seancë përgatitore i cili ishte përgjigjur në pyetjet e palëve ndërjgjyjëse duke dhënë kështu edhe sqarime shtesë për sa i përket ekspertizës së përpiluar. Mirëpo, nga të

gjeturat e sipërpërmendura, Gjykata e Apelit vlerëson se është obligim e gjykatës së shkallës së parë që të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plot gjendjen faktike dhe atë duke vërtetuar bazën juridike të kërkesës së paditësit në atë mënyrë që me rastin e deklaramit të ekspertit duhet të sqarohet para gjykatës për mënyrën e përpilimit të ekspertizën duke përcaktuar me përqindje (%) përgjegjësinë e pjesëmarrësve në aksident, pasi që i njëjti është dashur të deklarohet me përgjegjësin primare dhe ajo sekondare, ndërsa përcaktimi me përqindje (%) nuk bie në kompetencë të ekspertit, mirëpo ndarja e përgjegjësisë në përqindje (%) është kompetencë dhe vlerësim ekskluziv i gjykatës. Andaj, duke qenë se aktgjykimi i ankimuar ishte përfshirë në shkëlqje thelbësore dhe si rrjedhojë e kësaj edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, tani për tani edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar dhe për këtë arsye aktgjykimi i ankimuar u deshtë të priset në tërësi dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Në ri procedurë, udhëzohet gjykata e shkallës e parë që të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, ashtu që pasi të konstatoj se janë plotësuar të gjitha kushtet procedurale për vendosje në këtë çështje kontestimore, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me qëllim të vërtetimit të përgjegjësisë së paditësit dhe të paditurit në aksidentin në vendin e punës të datës 10.10.20211, ashtu që fillimisht të sqarohen rrethanat e cekura si më lartë, të vlerësoje përgjegjesinë e paditësit dhe të paditurës vec e vec, ashtu që shkalla e përgjegjësisë të pasqyrohet edhe me përqindje % , në mënyrë që të vërtetohet drejtë dhe saktë baza juridike e kërkespadiisë dhe rrjedhimit edhe lartësia e kërkespadiisë e dëmit, tw sqaroj dhe vwrteoj bazwn juridike tw padisw sa i pwrket kwrkeswpadisw pwr dwmin jo material pwr paditwsit tjerw, duke marrw pwr bazw natyrwn e lwndimeve tw paditwsit tw cilat nuk cilwsohen si lwndime tejet tw rwnda por vetwm si lwndime tw rwnda trupore, të administrojë dhe vlerësoj drejtë të gjitha provat në shkresat e lëndës dhe pas administrimit dhe vlerësimit të tyre, secilën vec e veç dhe të gjitha se bashku në lidhshmëri me njëra-tjetrën, të vendosë në mënyrë meritorë për themelësinë e kërkesepadiisë, duke u bazuar në dispozitat e të drejtës materiale dhe në atë mënyrë të nxjerr një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, duke e arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, e i cili në pikëpamje formale dhe materiale duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, dhe 195 parag.1 pika (c), nw lidhje me nenin 209, pika d) e LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1196/2021, datë 20.05.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka